



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 49

Datë: 17.11.2020. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Eshref Vishi, anëtarë i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Ibrahim Selmanaj, Artan Asllani, Nend Rikallo, Rifat Krasniq.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Eshref Vishi, anëtarë i KQZ-së.**
- 2. Aktivitetet e SKQZ-së:**
- 3. Aktivitetet e ZRPPC-së:**
 - Shqyrtim dhe miratimi i rekomandimit për akreditim të vëzhguesve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut;
- 4. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**
 - **Këshilli për Çështje ligjore;**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Vushtrrisë.
 - Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzimit Administrativ 02/2020, për publikim dhe përditësimin e informatave në ueb faqen e KQZ-së,

- Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzimit Administrativ 03/2020, për masat mbrojtëse për parandalimin infeksionit me COVID-19, për votuesit dhe stafin zgjedhor në ditën zgjedhjeve.

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i formave zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicën e veriut, 29.11.2020,
- Shqyrtimi dhe miratimi i afatit të identifikimit dhe konfirmimit për votuesit të cilët për shkak të testit pozitiv me COVID-19 të cilët janë në karantinë shtëpiake dhe votuesit të cilëve iu është caktuar masa e vetë izolimit,
- Shqyrtimi dhe miratimi i fletëvotimit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut.

5. Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik:

Aktivitetet e Këshillit për Informim Publik,

6. Të ndryshme.

1.Hyrje: z. Eshref Vishi, anëtarë i KQZ-së:

Eshref Vishi: Përshëndetje, në bazë të rregullores së punës dhe autorizimit të kryetares, unë do ta kryesoj këtë mbledhje. Konsideroj se kuorumi është për vazhdimin e mbledhjes. Ju lus që mbarëvajtjen e mbledhjes, të respektohet takimi. E keni rendin e ditës...! Kush është për këtë rend dite, apo ka dikush ndonjë propozim ?

Alim Rama: Po dikutoj për atë që javën e kaluar unë e kam ngritur çështjen e KKZ-ve në Mitrovicë, ku një prej anëtarëve të KKZ-së ka qenë ish anëtare e PDK-së. Pra, nuk kemi informacion, nuk është në rend dite...A duhet me b'a ndryshimin, me shkarkue... Një parti, nuk mundet me pas dy anëtarë...Tjetra, KQZ e ka shpallë listën e QV-ve, në Mitrovicën e veriut duke mos respektuar rregulloren 016/2013. QV është në pronësi private të personave fizik, e kjo nuk bahet pa një vendim të KQZ. Ne, i kemi 2 QV në objekte private...njëra, në pronën e asamblistit komunal në Mitrovicën e veriut...

Nuk mundemi me vazhdua me shkeljen e ligjit..

Eshref Vishi: KOZ-i bënë shqyrtimin e KVV-e, dhe kjo pikë e rendit të ditës është shqyrtua dhe miratua në KOZ. Unë, besoj se Sekretariati është marrë me këtë kërkesë tuajën, ani pse nuk e di se në cilën fazë është...

Burim Ahmetaj: Sekretariati, është duke i trajtuar këto dy tema, dhe në mbledhjen e radhës do t'i sjellim trajtimet tona...

Alim Rama: Ne, jemi 9 ditë para zgjedhjeve. Votuesit, duhet me ditë ku e kanë qendrën e votimit, e ne nuk mund të presim mbledhje mbas mbledhje. Sekretariati, ka bërë publikimin e QV-ve, pa i trajtuar në KOZ.

Eshref Vishi: Faleminderit. Unë mendoj se Sekretariati i ka marrë seriozisht këto shqetësime...Ne, do ta kemi edhe një mbledhje këtë javë...

Rendin e punës, e qesë në miratim. Nuk ka abstenim, kundër nuk ka, miratohet rendi i ditës.

2.Aktivitetet e SKQZ-së:

Burim Ahmetaj: Raporti, u është dërguar me shkrim. Sipas planit, janë dy periudha që kanë përfunduar: Periudha e kundërshtimit dhe e konfirmimit të listës së Votuesve, dhe periudha e shërbimit të votuesve për ndërrimin e QV-ve. Sekretariati, me kohë i ka pajisur me CD – me listat preliminare të Podujevës dhe Mitrovicës së veriut, dhe po ashtu, i ka ftuar edhe përfaqësuesit e subjekteve politike që të pajisen me këto CD që përmbajnë të dhënat e votuesve për secilën komunë, dhe për secilën QV...

I ka publikuar edhe Listat Preliminare që janë dërguar në KKZ, dhe të cilat janë publikuar. Nuk ka pasur raste të kundërshtimit, dhe më 16 nëntor e kemi marrë ekstraktin e fundit të Regjistrimit Civil. Prandaj, ne jemi në përgatitje përfundimtare të LV-së.

Në periudhën e shërbimit të votuesve për ndërrimin e QV-ve, janë parashtruar 65 kërkesa: në komunën e Podujevës janë 63 kërkesa (53 kërkesa janë parashtruar në zyrën e KKZ-së, dhe 11 të tjera përmes platformës online), dhe 2 kërkesa në Mitrovicën e veriut përmes platformës online. Në Mitrovicën e veriut, janë trajnuar të gjithë trajnerët...

Për të dy komunat, janë dërguar ftesat për nominimin e anëtarëve të KVV-e: Në komunën e Podujevës për konfirmimin e anëtarëve sepse, ata i kemi tashmë, Mirëpo janë 30 anëtarë për tu nominuar. Në komunën e Mitrovicës, janë në proces e sipër...

Më 10 nëntor, është mbajtur programi orientues i sigurisë, dhe janë koordinua aktivitetet së bashku me faktorët relevant-institucionet e caktuara...

Sami Kurteshi: Tek ndryshimi i QV-ve, z. Rama shtroi pyetje: a janë ato përfundimtare, domethënë caktimi i anëtarëve, a mund të bëhen ndryshime apo jo, sepse ka QV që janë vendosur në qendra private...

Burim Ahmetaj: Në bazë të planit operacional, është edhe ndërrimi i QV-ve, mirëpo KQZ jep mundësinë që QV të jenë sa më afër vendvotimeve...Ngase nuk ka pasur ndonjë ndryshim nga zgjedhjet e kaluara, kemi konsideruar se ato janë qendra të njëjta dhe ju kemi referuar atyre...Por, ne jemi në shqyrtim e sipër...

Sami Hamiti: Nuk pajtohem me Alimin, sepse nuk shoh ndryshim sepse, nuk janë mundësitë të ketë ndryshime. Në zgjedhjet e tjera, duhet ta shohim çështjen edhe të këtij objekti privat...Konsideroj që nuk është mirë të jetë, por ka një procedurë dhe nuk mund të realizohet...Sekretariati, duhet të tregoj se nuk mund të bëjë ndryshime sepse, janë vetëm 9 ditë nga dita e zgjedhjeve...Unë s'kam pasur këtë informacion, sepse sigurisht do të kisha qenë kundër...

Nenad Rikallo: Ky objekt është ku është, dhe po e shpjegoj se edhe atëherë ka pas diskutime por, nuk ka mundur të sigurohet objekt sepse, ka qenë afër dhe i përshtatshëm për votues. Aty ku është lagja e Boshnjakëve, nuk ka seli zyrtare. Në rrethana të këtilla, s'ka pasur mundësi për ndryshim...S'ka pasur zgjidhje sepse, në këtë lagje nuk ka pasur hapësirë të nevojshme... Gjendja është kjo, por edhe zgjedhjet janë të jashtëzakonshme, në këtë rrethinë nuk ka pasur tjetër zgjidhje...

Kam edhe një pyetje: S'i është zhvilluar trajnimi...? Dhe, pyetja tjetër deri ku janë përgatitur materialet zgjedhore...? Sepse, duhet të jemi të sigurve në proces...

Burim Ahmetaj: Kemi marrë parasysh këshillat dhe procedurat e lejuara të IPSHK-së mbi Covid-19, dhe në bazë të kësaj kemi marrë masat dhe jemi duke e përgatitur udhëzimin që, i referohet edhe trajnimit. Ne, nuk mund të organizojmë trajnime më shumë se për dy ekipe, padyshim duke marrë parasysh çdo specifikë, qoftë të institucioneve, qoftë të KQZ-së.

Materialet zgjedhore, janë në finalizimi e sipër...Por, kjo po vazhdon me intensitet...Nuk do të ketë vonesa...

Alim Rama: Në mbledhjen tjetër, ne na interesojnë pikat kryesore të organizimit dhe materialeve. Kurse për objektin, KQZ nuk e ka pasur në posedim tërë vitin. Është bërë kontrata njëburimore...Kjo është papërgjegjësi, sepse ka mundur të bëhen përmirësime transparente...

Sami Kurteshi: Unë, pak po shoh se ka ngecje në plan dhe ne s'i KQZ, propozoj që të kemi mbledhje të vazhdueshme të KQZ, qesim madje edhe s'i vetëm një pikë...

Eshref Vishi: Mendoj që administrata duhet t'i prezantojë informacionet me kohë, në mënyrë që të mos vie deri te situatat s'i kjo...

3.Aktivitetet e ZRPPC-së:

Shqyrtim dhe miratimi i rekomandimit për akreditim të vëzhguesve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut:

Yll Buleshkaj: Zyra, po vazhdon sipas planit operacional. Në këtë kohë merremi më shumë me akreditimin e vëzhguesve... Por, siç kam informua edhe në mbledhjen e kaluar, kemi një aplikim për regjistrimin e një partie të komuniteti boshnjak, dhe kemi në këshillim edhe dy iniciativave të reja të komunitetit shqiptarë...

Në anën tjetër, kemi marrë konfirmimin nga LDK për vëzhguesit në komunën e Podujevës, dhe sipas mundësisë së për ndërrimin ose rritjen e vëzhguesve...Në kontekst, kemi ndërrim për 24 vëzhgues

dhe se, kjo ndodh për shkak se gjysma me gjasë kanë kaluar si anëtarë të KVV-e... Pra, janë 24 vëzhgues të LDK-së shtesë, që duhet ti akreditojmë...

Dokumentacioni është sjellë, kështu që ne, rekomandojmë për akreditim...!

Kemi marrë edhe konfirmim edhe nga LVV, dhe jemi në proces të verifikimit edhe njëherë të gjithë listës.

Eshref Vishi: Pra, kush është që këta vëzhgues të akreditohen ?

Anëtarët e KQZ-së, në mënyrë unanime u akredituan këta 24 vëzhgues të LDK-së.

Sami Hamiti: Është mirë që të gjitha subjekteve të njoftohen se në vendotimeve do të shkohet sipas rekomandimeve të IPSHK-së...

Yll Buleshkaj: Jemi duke e përgatitur udhëzimin, dhe ata do të jenë të informuar me kohë.

4.Raporti i Këshillave të KQZ-së

1.Këshilli për Çështje ligjore

1.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Vushtrrisë:

Arianit Elshani: Këshilli në mbledhje, ka trajtuar kërkesën për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në komunën e Vushtrrisë, dhe se këshilli mbasi që ka trajtuar ligjshmërinë e kësaj kërkesë ka vendosur që t'i rekomandoj KQZ-së këtë zëvendësim, meqë i plotëson të gjitha kushtet...!

Eshref Vishi: Atëherë, pra kush është për që z. Ilir Krasniqi, të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtri nga subjekti politik PDK, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm z. Safet Idrizi.

Anëtarët e KQZ-së, në mënyrë unanime miratuan këtë zëvendësim.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzimit Administrativ 02/2020, për publikim dhe përditësimin e informatave në ueb faqen e KQZ-së:

Arianit Elshani: Këshilli në mbledhje, ka trajtuar udhëzimin administrativ 02/2020, për publikim dhe përditësimin e informatave në ueb faqen e KQZ-së. Para vetës, e kemi udhëzimin. Mbi këtë, është më se e domosdoshme që ky udhëzim të miratohet, dhe ne e kemi trajtuar në mënyrë të veçantë, duke pasur parasysh rëndësinë dhe bazën ligjore. E kemi shqyrtuar, në fakt dy herë...

Sami Kurteshi: Kam vetëm pyetje: A janë integruar të gjitha çështjet, intervenimet, të gjitha...?

Arianit Elshani: Po.

Eshref Vishi: Kush është për...?

Konstatohet se në mënyrë unanime, u aprovua udhëzimi administrativ 02/2020 për publikim dhe përditësimin e informatave në ueb faqen e KQZ-së. Faleminderit. Kalojmë në pikë tjetër...!

3.Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzimit Administrativ 03/2020, për masat mbrojtëse për parandalimin infeksionit me COVID-19, për votuesit dhe stafin zgjedhor në ditën zgjedhjeve:

Arianit Elshani: Faleminderit. Të nderuar anëtarë dhe media, duke i pasur parasysh rrethanat dhe pandeminë, këshilli ka shqyrtuar udhëzimin administrativ 03/2020, për masat mbrojtëse për parandalimin infeksionit me COVID-19, për votuesit dhe stafin zgjedhor në ditën zgjedhjeve. Këshilli, e ka shqyrtuar gjerë e gjatë, ku edhe janë dhënë udhëzimet dhe se, synim është zbatimi me përkushtim i masave. Janë specifikuar distanca, mjetet mbrojtëse, materialet shëndetësore etj.

Udhëzimi, është bërë mbi bazë ligjore, s'i edhe mbi udhëzimet e institucioneve shëndetësore, andaj rekomandojmë për miratim.

Eshref Vishi: Kush është për...?

Konstatohet se me vota unanime, u miratua edhe ky udhëzim.

Arianit Elshani: Kryesues, lidhur me këtë udhëzim kërkoj që të diskutoj drejtori i ZRPP-së.

Yll Buleshkaj: E kemi paraqitur një kërkesë, në fakt një rekomandim sipas së cilës, partive politike tu shtyhet afati për mbajtjen e kuvendeve zgjedhore. Ato subjekte që kanë pasur ti mbajnë në nëntor dhe dhjetorë. Kjo, sepse përkundrejt ligjit, kemi masat anticovid, dy vendime të qeverisë dhe për këtë, janë 4 parti që kanë pasur ti mbajnë zgjedhjet deri në fund të vitit, por ne kërkojmë që këtyre subjekteve për vitin e ardhshëm...Pra, këto subjekte edhe kanë shprehë kërkesën për shtyrje...

Ne, kërkojmë që kjo të mundësohet nga KQZ...!

Eshref Vishi: Afati është mirë të caktohet. Unë, e për krahi këtë rekomandim të ZRPP-së. Në fakt, subjekti im Nisma, është brenda këtij procesi, dhe se është e pamundur të qohet procesi përpara në këto rrethana...! Pra, të kemi një shtyrje por, të afatizuar.

Arianit Elshani: Edhe ne e kemi shqyrtuar në këshill. Në këto rrethana, duhet të kemi një qëndrim, por edhe një afatizim...një datë...!

Sami Hamiti: Në parim, pajtohem që të shtyhet, por padyshim duhet të përcaktohet një afat, një afat referues...!

Sami Kurteshi: Po, mendoj që kemi një pajtim që afati të shtyhet. Edhe kërkesa për caktim date, është e ligjshme... Sipas kushtetutës, ka një precizim për "rrethana të jashtëzakonshme" deri në 90 ditë...!

Alim Rama: Ky afat, nuk duhet të jetë blanko...!

Në këtë pikë, diskutuan më tej: Sami Hamiti dhe, Sami Kurteshi.

Eshref Vishi: Atëherë, ky afat të jetë deri më, **1 qershor 2021**. Kush është për...?

Anëtarët e KQZ, miratuan kërkesën e ZRPP me vota unanime që afati për 4 subjekte politike që kanë kërkuar shtyrjen e mbajtjes së kuvendeve zgjedhore, të jetë deri më 1 qershor 2021.

5. Këshilli për Operacione Zgjedhore

1.Shqyrtimi dhe miratimi i formave zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicën e veriut, 29.11.2020:

Alim Rama: Për disa forma zgjedhore disa rekomandime, nuk janë përfshi në këtë forma që na janë prezantuar këtu! Po flas, veçanërisht për Librin e Votimit...

Eshref Vishi: A ka pasur vërejtje në KOZ...? Nuk janë bërë përmirësime, apo...?

Burim Ahmetaj: Ka të drejtë kryesuesi i KOZ-it, por duhet të ndërrohet tabele teknikisht, dhe kemi menduar që kështu duhet të jetë... Sigurisht, do të bëjmë përmirësime...

Eshref Vishi: Sqaroheni mirë, a ka mundësi teknike...?

Burim Ahmetaj: Do të bëjmë përpjekje, të shohim s'i është e mundshme...!

Në këtë pikë, diskutuan edhe: Sami Hamiti, Arianit Elshani, Burim Ahmetaj, dhe Alim Rama.

Eshref Vishi: Po e hedh në votim. Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, në parim e miratuan këtë rekomandim, duke i përfshirë të gjitha vërejtjet e dhëna...edhe në KOZ.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i afatit të identifikimit dhe konfirmimit për votuesit të cilët për shkak të testit pozitiv me COVID-19 të cilët janë në karantinë shtëpiake dhe votuesit të cilëve iu është caktuar masa e vetë izolimit:

Alim Rama: E kemi trajtuar këtë rekomandim të Sekretariatit, dhe e kemi miratuar në mënyrë unanime.

Mbas shpjegimit më të hollësishëm, z. Rama, tha se data e fundit e identifikimit dhe konfirmimit, do të jetë 26 nëntor.

Diskutuan në këtë pikë: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Eshref Vishi, Artan Asllani.

Në fund me 6 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, miratohet.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i fletëvotimit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut:

Alim Rama: Një vërejtje e DOZ-it, ka qenë, se pse formati A/4, e që ka mundur të jetë A/5. Mirëpo, tash nuk kemi mundur të bëjmë ndryshim...

Sami Hamiti: Po, ishin në pozitë të caktuar. Por, hera tjetër të shkohet në prokurim në të ardhmen me dy propozime, dhe të zgjidhet sipas vendosjes këtu...

Eshref Vishi: E hedh në votim...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan fletëvotimin për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut:

6. Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik

Aktivitetet e Këshillit për Informim Publik:

Arianit Elshani: Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik, në mbledhjet e veta ka shqyrtuar dhe miratuar tekstin për periudhën e kundërshtimit dhe konfirmimit të Listës Votuese, e bashkë edhe tv spotin dhe radiospotin; Tekstet: S'i të plotësohet Fletëvotimi, S'i të votohet përmes Postës; Mediaplanet për transmetimin e tvspotit dhe radiospotit në televizionin lokal dhe në radion lokale...

Pastaj, ka shqyrtuar tvspotin dhe radiospotin për periudhën e ndrrimit të qendrës së votimit në gjuhën serbe, edhe atë të kundërshtimit dhe të konfirmimit të listës së votuesve...

Është miratuar edhe teksti për realizimin e tvspotit për informimin për mënyrën e votimit të votuesve të infektuar me covid – 19, dhe në vetë izolim.

Të gjitha këto produkte, kanë filluar që të publikohen në ueb faqen e KQZ, në rrjete sociale në komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së veriut, kurse jemi edhe në përgatitje të një tv spoti për persona që janë në izolim, dhe ata që do të votojnë përmes ekipeve mobile...

Eshref Vishi: E mbylli këtë takim, dhe mirupafshim në takimet e radhës...

7. Të ndryshme.